



NJOFTIM PËR KONTRATË

Kontratë Furnizimi

Procedurë konkurruese me negocim

Në përputhje me Nenin 12 të "Rregullës për Prokurimin në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës" (1 dhjetor 2024)

Data: 12.06.2026

Nr. i Prokurimit: "BQK 26 051 113"

I EMRI DHE ADRESA

Emri zyrtar: Banka Qendrore e Republikës së Kosovës	
Adresa: Rr. Luan Haradinaj nr 2, 10000 Prishtinë	
Qyteti: Prishtinë	Kodi postar: 10000
URL (nëse aplikohet): www.bqk-kos.org	
Kontakt: Divizioni i prokurimit dhe kontraktimit	E-mail: prokurimi@bqk-kos.org
Telefoni: 038 222 055/452	Fax: 038 243 763

II LËNDA E KONTRATËS

II.1 PËRSHKRIMI

Titulli i kontratës: "Furnizim me automjet transportues (furgon) të blinduar"
Lloji i prokurimit: Furnizim
Vendi kryesor i realizimit: BQK
Informacione të marrëveshje afatgjatë (nëse aplikohen): N/a
Variantet pranohen: Jo
Vlera e parashikuar e kontratës: 150,000.00 Euro
Ndarja në Pjesë: JO

III INFORMACIONE PËR LLOJIN E FURNIZIMIT

Qëllimi i kontratës është furnizimi me një automjet të ri të blinduar të tipit furgon (VAN), me sistem automatik të transmetimit, motor diesel, kapacitet transporti për ekuipazh dhe ngarkesë, si dhe me sisteme të integruara të sigurisë dhe mbrojtjes.

Automjeti do të pajiset me nivel të avancuar të blindimit balistik për kabinën dhe hapësirat e brendshme, xhama balistikë, sisteme elektronike të sigurisë, alarm, interkom, sisteme kontrolli të qasjes, kamera monitorimi, pajisje emergjente dhe elemente të tjera të sigurisë fizike dhe operative.

Specifikimet teknike të detajuara, kërkesat për certifikim, standardet e blindimit, dokumentacioni teknik dhe kriteret shtesë për mundësitë teknike dhe profesionale do t'u dërgohen kandidatëve që përzgjidhen dhe ftohen të paraqesin tender në fazën e dytë të procedurës.

IV KRITERET E PËRZGJEDHJES¹/KUSHTET E OBLIGUESHME PËR PJESËMARRJE

Të gjitha kompanitë (operatorët ekonomik) e interesuara janë të obliguara që t'i dorëzojnë së bashku me kërkesat për pjesëmarrje/aplikacionet e tyre dokumentet për përshtatshmëri siç kërkohet këtu në vijim:

<p>Pranueshmëria e Operatorëve Ekonomik – <i>Kjo kategori e dokumenteve (kërkesat 1 dhe 2 është e obligueshme në dorëzim me kërkesën për pjesëmarrje/aplikacion dhe se nuk mund të plotësohet dhe/ose sqarohet pas dorëzimit të ofertës!</i></p>	<p>Kërkesa 1: Deklarata nën betim se tenderuesi/kandidati përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë.</p> <p>Evidenca 1: Deklaratë nën betim e plotësuar dhe nënshkruar duke përdorur formën në “Aneksin 1” të dokumentit për përzgjedhje.</p> <p>Kërkesa 2: Formulari i dorëzimit të kërkesës për pjesëmarrje/aplikacionit në formën standarde siç gjendet në Dokumentin për Përzgjedhje, Pjesa III</p> <p>Evidenca 2: Formulari i dorëzimit të kërkesës për pjesëmarrje/aplikacionit duhet të plotësohet me informatat siç kërkohen në formular dhe duhet të nënshkruhet dhe vuloset</p>
<p><i>Kërkesat mbi përshtatshmërinë profesionale – Për këtë kategori të dokumenteve (kërkesat 3, 4 dhe 5) mund të kërkohen dokumentacion plotësues ose sqarime</i></p>	<p><u>Dëshmitë lidhur me kërkesat e përshtatshmërisë profesionale do të kërkohen dhe dorëzohen nga tenderuesit/kandidatët para se Banka Qendrore të merr vendimin final për përzgjedhje.</u></p> <p>Kërkesa 3: Dëshmi nga administrata tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se tenderuesi në fjalë nuk është me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para dorëzimit të kërkesës për pjesëmarrje/aplikacionit.</p>

¹ Sipas nenit 32 të Rregullës për prokurimin në BQK “Kriteret e përzgjedhjes”

	<p>Evidenca 3: Një vërtetim i lëshuar nga Administrata Tatimore e vendit tuaj të themelimit, se ju nuk jeni me vonesë në pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit përpara dorëzimit të kërkesës për pjesëmarrje/aplikacionit.</p> <p>Kërkesa 4: Regjistrimi si tenderues në regjistrin profesional, komercial dhe/ose të korporatës në vendin e juaj të themelimit.</p> <p>Evidenca 4: Kopja e certifikatës së regjistrimit me informatat mbi biznesin.</p> <p>Kërkesa 5: Dëshmi se kompania nuk është në falimentim ose nën administrim të dhunshëm gjyqësorë të lëshuar nga Gjykata.</p> <p>Evidenca 5: Vërtetim nga Gjykata për Çështje Ekonomike i lëshuar së paku deri në tremujorin e fundit përpara dorëzimit të kërkesës për pjesëmarrje/aplikacionit.</p>
Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare	Nuk aplikohen
Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale – <i>Për këtë kategori të dokumenteve mund të kërkohen dokumentacion plotësues ose sqarime</i>	<p>Kërkesa 6: Tenderuesi/kandidati duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses së paku një kontratë të furnizimeve me automjete ose automjeteve të specializuara ose pajisjeve të sigurisë ose zgjidhjeve të ngjashme, gjatë 3 (tri) viteve të fundit (2023, 2024 dhe 2025, përfshirë edhe 2026 deri në shpalljen e këtij njoftimi për kontratë).</p> <p>Evidenca 6. Tenderuesi duhet ta plotësoj formularin standard për kontratat e ngjashme përdorur formën në “Aneksin 4” të dokumentit për përzgjedhje.</p> <p>Formulari në “Aneksin 4” i plotësuar dhe nënshkruar/vulosur me furnizimet e ngjashme të realizuara ne tri vitet e fundit duke saktësuar furnizimet e realizuara, shumën e kontratës (nëse është e mundur), datën dhe pranuesin si dëshmi për secilën prej furnizimeve si dhe te dhënat e personit përgjegjës nga autoriteti kontraktues (si nr. i telefonit, email adresa etj)</p> <p><u>Kandidatët njoftohen se, përveç kritereve të përcaktuara më lartë për fazën e parë të procedurës, kandidatëve që përzgjidhen dhe ftohen të paraqesin tender në fazën e dytë do t'u kërkohet të përmbushin edhe kërkesa shtesë lidhur me mundësitë teknike dhe/ose profesionale. Këto kërkesa dhe dëshmitë përkatëse do të përfshihen në dokumentet e</u></p>

	<p><u>tenderit që do t'u dërgohen kandidatëve të ftuar në fazën e dytë të procedurës dhe përfshijnë, ndër të tjera:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> • Katalogun me specifika teknike dhe fletë-datën teknike (Technical Data Sheet) të modelit të ofertuar; • Autorizimi nga prodhuesi, distributori, importuesi i autorizuar, marrëveshje të bashkëpunimit ose dokumentacionit tjetër ekuivalent që dëshmon mundësinë dhe të drejtën e furnizimit të automjetit të ofertuar • Autorizimin nga kompania blinduese dhe/ose dokumentacion tjetër që dëshmon marrëdhënien zyrtare me kompaninë blinduese; • Deklaratën e konformitetit me standardet përkatëse UNI EN për masat e sigurisë; • Certifikatat balistike të pjesëve të blinduara; • Udhëzuesin e përdorimit të sistemeve të sigurisë dhe planin e trajnimit të personelit; • Deklaratën mbi garancinë minimale; • Dëshmi dhe dokumente të tjera teknike që do të specifikohen në dokumentet e tenderit.
<p>Krijimi i një grupi të kandidatëve</p>	<p>a. një deklaratë e qartë ku të gjithë anëtarët e grupit janë bashkërisht dhe individualisht përgjegjës tek Banka Qendrore gjatë procesit të para-kualifikimit dhe, në rast se grupi para-kualifikohet, gjatë procesit të tenderimit, dhe në rast se grupit i epet kontrata, gjatë ekzekutimit të kontratës.</p> <p>b. Një deklaratë të nënshkruar nga secili anëtarë, duke konfirmuar pjesëmarrjen e tyre në grup dhe se ata nuk janë duke marrë pjesë në mënyre individuale dhe/apo në ndonjë grup tjetër që marrin pjesë në procedurën e njëjtën të prokurimit;</p> <p>c. një deklaratë të nënshkruar nga të gjithë anëtarët e grupit të cilët autorizojnë partnerin kryesor për të vepruar në emër të grupit, dhe</p> <p>d. Të gjitha anëtarët e grupit të tillë duhet të jenë të përshtatshëm dhe do të sigurojnë dëshminë mbi përshtatshmërinë e tyre, siç është përmendur në paragrafin 5.4 të Fletës së të dhënave për përzgjedhje (FDP).</p>

V PROCEDURA

V.1 Lloji i procedurës: “Procedurë konkurruese me negociim” (Neni 12 i Rregullës për Prokurimin në BQK)

VI. KRITERET PËR DHËNIEN E KONTRATËS: “Tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët” (në përputhje me nenin 34 të Rregullës për prokurimit në BQK)

VII. INFORMATA ADMINISTRATIVE

Kushtet për marrjen e Dokumentit për Përzgjedhje/Kërkesës për Pjesëmarrje: Dokumenti për Përzgjedhje/Kërkesës për Pjesëmarrje është i bashkangjitur me këtë njoftim për kontratë (shih në vazhdim të njoftimit).	
Afati i fundit për të paraqitur kërkesë nga kandidatët/tenderuesit për sqarime shtesë, data: 19.06.2026, ora 16:00, në e-mail adresën zyrtare: prokurimi@bqk-kos.org .	
Dokumentet me pagesë: Jo	
Afati i fundit i dorëzimit të kërkesave për pjesëmarrje/aplikacioneve, data: 24.06.2026, ora 14:00 ; në objektin e BQK-së, Zyra e Arkivit, Rr. “Luan Haradinaj” nr. 2, Prishtinë.	
Takimi për hapjen e kërkesave për pjesëmarrje/aplikacioneve, data: 24.06.2026, ora 14:30 , Objekti i BQK-së, Rr. “Luan Haradinaj” nr. 2, Prishtinë.	
Periudha e vlefshmërisë së kërkesës për pjesëmarrje/aplikacionit: 90 ditë nga data e dorëzimit respektivisht e hapjes së ofertave	

VIII. ANKESAT

<p>Në përputhje me “Rregullën për Prokurimin në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (dhjetor 2024)”, respektivisht sipas Neni 48 “Procedura e ankesës”, çdo palë e interesuar mund të bëjë ankesë pranë Bankës Qendrore: Rr Luan Haradinaj nr. 2, 10000 Prishtinë, www.bqk-kos.org, brenda 5 ditësh nga data e shpalljes së këtij njoftimi. Ankesa nga pala e interesuar ²lidhur me këtë procedurë duhet të përmbajë të gjitha elementet e cekura si në dosjen e tenderit dhe fizikisht duhet të dorëzohet në Arkivën e BQK-së brenda afatit për t’u konsideruar e vlefshme. Pala ankuese duhet të paguajë një tarifë për parashtrim të ankesës pranë Bankës Qendrore, vlera e së cilës do të jetë deri në 1% të vlerës së ofertës përkatëse, jo më pak se 100 euro dhe jo më shumë se 2,500 euro. Në të kundërtën refuzohet menjëherë nga ana e BQK-së. Ankesa e parashtruar pa dëshminë e pagesës që duhet të sigurohet nga pala ankuese do të refuzohet që në pranim të parë nga Banka Qendrore.</p>
--

IX. ADRESA

Rr. Luan Haradinaj nr 2	
Qyteti: Prishtinë	Kodi postar: 10000
URL (nëse aplikohet): www.bqk-kos.org	

² Sipas pikës 1.26 të Nenit 2 të “Rregullës për Prokurimin në BQK”, “palë e interesuar” është operatori ekonomik i cili mund të dëshmojë interes material nga rezultati i një aktiviteti të prokurimit të zbatuar nga Banka Qendrore në raport me një kontratë të prokurimit.

Personi kontaktues: Divizioni i prokurimit dhe kontraktimit	E-maili: prokurimi@bqk-kos.org
Telefoni: 038 222 055/451	Fax: 038 243 763



DOKUMENTI PËR PËRZGJEDHJE/KËRKESË PËR PJESËMARRJE

Sipas Nenit 12 të Rregullës për Prokurimin në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës

FURNIZIM *PROCEDURA KONKURRUESE ME NEGOCIM*

Faza e parë

Data kur është përgaditur dokumenti:

12.06.2026

Prokurimi Nr ³	BQK	26	051	113
---------------------------	-----	----	-----	-----

Titulli: “Furnizim me automjet transportues (furgon) të blinduar”

KY DOKUMENT PËRBËHET PREJ KATËR PJESËVE:

Pjesa I: Udhëzime për tenderuesit/kandidatët

Pjesa II: Fleta e të Dhënave për Përzgjedhje

Pjesa III: Formulari i Dorëzimit të Kërkesave për Pjesëmarrje/Aplikacioneve

Pjesa IV: Anekset

³ Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me aktivitetin e prokurimit.

LËNDA: FTESA PËR PJESËMARRJE në aktivitetin e prokurimit “Furnizim me automjet transportues (furgon) të blinduar”

Ju faleminderit për interesimin tuaj në lidhje me pjesëmarrjen në aktivitetin e lartë-përmendur të prokurimit.

Sipas kërkesës suaj, ju lutem gjeni të bashkëngjitura dokumentet, të cilat përbëjnë Ftesën për Pjesëmarrje (Dokumentin për Përzgjedhje). Qëllimi i procesit të përzgjedhjes është që t’ju lejohet tenderuesve/kandidatëve të interesuar të paraqesin kërkesat për pjesëmarrje/aplikacionet e tyre për përfshirje në listën e tenderuesve/kandidatëve të kualifikuar të cilët do të ftohen që të tenderojnë për aktivitetin e prokurimit.

Procesi i prokurimit do të kryhet në dy faza:

Në fazën e parë të procedurës, faza e përzgjedhjes, nga tenderuesit/kandidatët kërkohet që t’i përmbushin kushtet për pjesëmarrje dhe kriteret e përzgjedhjes të përcaktuara në këtë dokument. Kërkesa për pjesëmarrje do të vlerësohet në bazë të kriterëve të përcaktuar në këtë dokument. Qëllimi është përzgjedhja e kompanive të afta në kryerjen e detyrave të tilla.

Në fazën e dytë të procedurës, faza tenderuese, të gjithë tenderuesit/kandidatët e përzgjedhur do të pranojnë “ftesën për tender” dhe do të ftohen që t’i paraqesin ofertat e tyre në bazë të specifikimeve të tenderit të siguruara në ftesën për paraqitjen e ofertave në “Dosje të Tenderit”.

Nga ju pritet që të ekzaminoni me kujdes të gjitha nenet, pjesët dhe anekset e këtij dokumenti dhe të pajtoheni me të gjitha kërkesat dhe kushtet e përfshira këtu.

Ne, si BQK nuk pranojmë asnjë ndryshim.

Dështimi i paraqitjes së kërkesës tuaj për pjesëmarrje tek BQK-ja, brenda afatit të specifikuar dhe/ose jo në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e vendosura në këtë dokument do të refuzohet dhe tenderuesi/kandidati do të eliminohet nga pjesëmarrja e mëtutjeshme. .

Të gjitha shpenzimet që lidhen me përgatitjen dhe me dorëzimin e kërkesës për pjesëmarrje/aplikimit do të barten nga tenderuesi/kandidati, ndërsa BQK nuk do të ketë asnjë detyrim në rast se anulohet procedura.

Kjo procedurë e tenderimit është e rregulluar me Rregullën për Prokurimin në BQK. Sipas Nenit 12 paragrafit 4 të kësaj rregulle, duhet të ketë së paku 3 (tre) kandidatë të cilët i plotësojnë kriteret e përzgjedhjes në fazën e parë.

Rregulla për Prokurimin në BQK mund të shkarkohet nga uebfaqja e BQK-së: www.bqk-kos.org

Kërkesat për pjesëmarrje/aplikacionet duhet te dorëzohen në adresën e specifikuar në “Udhëzime për tenderuesit/kandidatët” *deri më datë 24.06.2026 në ora 14:00.*

Mirëpresim pranimin e Kërkesës tuaj për Pjesëmarrje.

Nëse vendosni të mos e dorëzoni kërkesën për pjesëmarrje/aplikimin tuaj, do të iu ishim mirënjohës nëse do të na lajmëronit me shkrim, duke cekur arsyet e vendimit të juaj.

TABELA E PËRMBAJTJES

<u>PJESA I: Udhëzime për tenderuesit (UPT)</u>	11
<u>Të Përgjithshme</u>	11
<u>KËRKESAT të cilat duhet të plotësohen nga TENDERUESIT</u>	11
<u>Kërkesat minimale kualifikuese</u>	13
<u>Përmbajtja e Dokumenteve të Para-kualifikimit</u>	14
<u>Përgatitja e APLIKACIONEVE</u>	15
<u>Dorëzimi dhe Hapja e Aplikacioneve</u>	16
<u>Procedurat për Vlerësimin e Aplikacioneve</u>	16
<u>PJESA II: FLETA E TË DHËNAVE PËR PARAKUALIFIKIM (FDP)</u>	19
<u>PJESA III: FORMULARI I DOREZIMIT TË APLIKACIONEVE</u>	23
<u>PJESA IV: ANEKSET</u>	25
<u>Aneksi 1 DEKLARATA NËN BETIM</u>	25
<u>Aneksi 2 KËRKESË PËR KONFIDENCIALITET</u>	26
<u>Aneksi 3 KËRKESË PËR INFORMATA SHITESË</u>	27

PJESA I: Udhëzime për tenderuesit/kandidatët (UPT)

Të Përgjithshme

1. Fusha e Aplikimit

1.1 Në lidhje me Ftesën për Pjesëmarrje, BQK i **cekur në Fletën e të Dhënave për Përzgjedhje (FDP)**, lëshon këtë Dokument për Përzgjedhje DPP) për tenderuesit/kandidatët e interesuar për të tenderuar në këtë aktivitet të prokurimit.

1.2 Titulli i kontratës dhe numri identifikues i këtij aktiviteti të prokurimit janë **shënuar në FDP**.

1.3 Procedura e prokurimit e përdorur për këtë aktivitet të prokurimit është **shënuar në këtë FDP**.

1.4 Informacioni mbi publikimin e Njoftimit të Kontratës janë **shënuar në FDP**.

1.5 Kërkesat për Pjesëmarrje/Aplikacionet duhet të dorëzohen në adresën e BQK-së të **shënuar në FDP**.

1.6 Përgjatë kësaj Dokumenti për Përzgjedhje:

a) shprehja “me shkrim” kuptohet komunikimi në formë të shkruar (p.sh. me e- mail) me dëshmi të pranimit;

b) nëse konteksi kërkon “njëjës” gjithashtu nënkupton “shumës” dhe anasjelltas;

c) “ditë” nënkupton ditën kalendarike;

d) ju jeni të referuar si “tenderues” dhe/ose “kandidatë”

e) Lëshuesi i këtij dokumenti është referuar si “ BQK”; dhe

f) “Kërkesa për Pjesëmarrje/Aplikimi” nënkupton dorëzimin e dokumenteve në mënyrë që të përzgjedheni.

2. Lloji i Kontratës

2.1 Lloji i kontratës është **shënuar në FDP**.

3. Qëllimi i kontratës

3.1 Klasifikimi i Fjalorit të Përgjithshëm të Prokurimit është **shënuar në FDP**.

3.2 Qëllimi i kontratës është **shënuar në FDP**.

4. Kushtet dhe kërkesat e dërgesës

4.1 Vendi i zbatimit të kontratës **siç është shënuar në FDP**.

KËRKESAT të cilat duhet të plotësohen nga TENDERUESIT/KANDIDATËT

Tenderuesit/kandidatët duhet t`i plotësojnë të gjitha kërkesat në vijim. Çdo mos përmbushje e ndonjëres nga kërkesat do të eliminoj aplikimin e tyre nga konkurrimi.

**5.
Përshtatshmëria e
tenderuesve**

Përshtatshmëria e kandidatëve/tenderuesve

5.1 Të gjithë personat fizikë dhe juridikë që janë banorë apo gjenden në Republikën e Kosovës kanë të drejtë pjesëmarrje në procedurat tenderuese të Bankës Qendrore. Procedurat e tenderit gjithashtu janë të hapura sipas kushteve të barabarta për të gjithë personat fizikë dhe juridikë që nuk janë banorë të Republikës së Kosovës apo vijnë nga vendet të tjera. Tenderuesit nga vendet e tjera mund të pranohen që të marrin pjesë sipas përzgjedhjes së plotë të Bankës Qendrore.

5.2 Grupet e përkohshme të partneritetit mund të marrin pjesë në një procedurë për tender sipas kushteve të caktuara në njoftimin për kontratë apo në ftesën për tender. Banka Qendrore mund të kërkojë nga grupet e tilla që të miratojnë një formë specifike ligjore nëse kontrata iu jepet atyre, nëse kjo formë është e nevojshme për përmbushjen e duhur të kontratës.

5.3 Banka Qendrore përjashton kandidatët apo tenderuesit nga pjesëmarrja në një procedurë për tender nëse kanë qenë objekt i ndonjë aktgjykimi të formës së prerë për mashtrim, korrupsion, shpëlarje parash, përfshirje në organizata kriminale apo në ndonjë aktivitet tjetër ilegal që dëmton interesat financiare të vendit dhe Bankës Qendrore.

5.4 Banka Qendrore mund t'i përjashtojë kandidatët apo tenderuesit nga pjesëmarrja në çdo kohë nëse ata:

(a) kanë falimentuar apo janë në likuidim, punët e tyre administrohen nga gjykatat, kanë hyrë në marrëveshje me kreditorët, kanë ndërprerë aktivitet afariste, janë objekt i procedurës lidhur me këto çështje, apo ndodhen në situatë të ngjashme si rrjedhojë e procedurës së njëjtë të paraparë në kornizën ligjore të vendit.

(b) janë dënuar me aktgjykim të plotfuqishëm për vepra që kanë të bëjnë me sjelljen e tyre profesionale;

(c) janë shpallur fajtor për shkelje serioze profesionale;

(d) nuk i kanë përmbushur obligimet e tyre lidhur me pagesën e kontributeve për sigurim social apo pagesën e taksave në përputhje me dispozitat ligjore të vendit në të cilin janë themeluar apo ato të vendit të autoritetit kontraktues apo ato të vendit ku do të përmbushet kontrata.

(e) janë shpallur nga një gjykatë apo (arbitrazh) se kanë bërë shkelje serioze të kontratës si dështim për t'iu përmbajtur obligimeve të tyre kontraktuese pas një procedurë tjetër të tenderimit;

(f) drejtuesit, personeli apo ndërmjetësit e tyre i nënshtrohen konfliktit të interesit;

(g) janë fajtorë për shpërdorim në ofrimin e informatave të kërkuara nga Banka Qendrore;

h) kanë kontaktuar kandidatët apo tenderuesit e tjerë me qëllim të kufizimit të konkurrencës .

5.5 Kandidatët apo tenderuesit duhet të vërtetojnë se ata nuk gjenden në ndonjë nga situatat e lartpërmendura dhe/apo t'i ofrojnë dëshmitë e specifikuar në njoftimin për kontratë apo në ftesën për tender. Nëse ngritën rrethana të tilla gjatë procedurës, kandidati/tenderuesi përkatës e njofton Bankën Qendrore pa vonesë lidhur me këtë.

Kërkesat minimale kualifikuese

6. Kërkesat mbi përshtatshmërinë profesionale

6.1 Tenderuesi/kandidati duhet ti plotësojë kërkesat e përshtatshmërisë profesionale **të shënuara në FDP.**

6.2 Në mënyrë që të dëshmohet se tenderuesi/kandidati është i përshtatshëm që të marrë pjesë në procedurën e prokurimit, tenderuesi/kandidati duhet t'i dorëzojë dokumente dëshmuese **të shënuara në FDP.**

7. Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare

7.1 Tenderuesi/kandidati duhet ti plotësojnë kërkesat minimale ekonomike dhe financiare **të shënuara në FDP.**

7.2 Në mënyrë që të dëshmohet se tenderuesi/kandidati i plotëson kërkesat minimale ekonomike financiare tenderuesi/kandidati duhet t'i dorëzojë dokumente dëshmuese **të shënuara në FDP.**

8. Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale

8.1 Tenderuesi/kandidati duhet ti plotësojnë kërkesat minimale mbi mundësitë teknike dhe/apo profesionale **të shënuara në FDP.**

8.2 Në mënyrë që të dëshmohet se tenderuesi/kandidati i plotëson kërkesat minimale mbi mundësitë teknike dhe/apo profesionale, tenderuesi duhet t'i dorëzojë dokumente dëshmuese **të shënuara në FDP.**

8.3 Banka Qendrore, me shpenzimet e tij, mund të kryejë një inspektim të kandidatëve tenderues për qëllime të verifikimit.

9. Informatat sekrete afariste

9.1 Nëse tenderuesi/kandidati dëshiron që ndonjë informatë lidhur me gjendjen ekonomike /financiare dhe aftësitë teknike/profesionale të trajtohet si informatë sekrete afariste, duhet të dorëzojë një kërkesë me shkrim duke përdorur formën e caktuar në këtë dosje të tenderit, shih Aneksin 2.

10. Krijimi i një grupi te ofertuesve

10.1 Nëse një aplikacion dorëzohet nga një grup i kandidatëve, grupi është i detyruar të **emëroj njërin nga anëtarët** e grupit si tenderues kontaktues dhe duhet të dorëzoj me dokumentet e kualifikimit, dokumentet e **shënuar në FDP**.

10.2 Nga një grup i tillë nuk do të kërkohet për të marrë përsipër ndonjë formë të veçantë ligjore për të paraqitur dokumentet kualifikuese, por Banka Qendrore rezervon të drejtën, nëse një kërkesë e tillë është e nevojshme për përmbushjen e mjaftueshme të kontratës, të kërkoj nga grupi i përzgjedhur për ta bërë këtë nëse kontrata i jepet një grup të tillë si parakusht për nënshkrimin e kontratës.

10.3 Tenderuesit nuk janë të lejuar që të aplikojnë në të njëjtën kohë në mënyrë individuale dhe si anëtarë të një grupi apo si anëtarë të grupeve të ndryshme. Në rastet e tilla tenderuesi dhe grupi i tillë do të jenë të papranueshëm.

11. Nën-kontraktimet

N/A

Përmbajtja e Dokumenteve për Përzgjedhje

12. Seksionet e Dokumentive për përzgjedhje

12.1 Dokumentet për Përzgjedhje përbëhen nga:

- Pjesa I: Udhëzimet për Tenderuesit/Kandidatët
- Pjesa II: Fleta e të Dhënave për Përzgjedhje
- Pjesa III: Formulari i Dorëzimit të Kërkesës për Pjesëmarrje
- Pjesa IV: Aneksat, dhe duhet të lexohet së bashku me çdo Shtojcë lëshuar në përputhje me Udhëzimet për Tenderuesit/Kandidatët Neni 14.

13. Sqarimet Dokumentit për Përzgjedhje

13.1 Tenderuesit/kandidatët janë të lejuar të bëjnë një kërkesë me shkrim pranë BQK-së për informata shtesë ose sqaruese që ata mendojnë se është e nevojshme për përgatitjen ose dorëzimin e një kërkesë për pjesëmarrje/aplikacioni të përgjegjshëm. Një kërkesë e tillë mund të bëhet me anë të përdorimit të formularit për kërkesë, shih Aneksin 3, dhe të dorëzohet tek Banka Qendrore në mënyrë elektronike, me shkrim . Banka Qendrore do të përgjigjet me shkrim çdo kërkesë për sqarim, me kusht që kërkesa e tillë është marrë jo më vonë se afati i **dhënë në FDP**. Banka Qendrore do të dërgon kopjet e përgjigjes së tij tek të gjithë ata që kanë siguruar Dokumentit për Përzgjedhje duke përfshirë pyetjen por pa e identifikuar burimin e saj. Nëse Autoriteti kontraktues e sheh të domosdoshme që të ndryshoj këtë dokument, si rezultat i sqarimit, atëherë duhet ta bëjë këtë sipas procedurës së përcaktuar në Nenin 14 Udhëzimet për Tenderuesit/Kandidatët.

14. Ndryshimi i Dokumentit për Përzgjedhje

14.1 Në çdo kohë para skadimit të afatit të fundit për dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje/aplikacioneve, Banka Qendrore mund të ndryshojë këtë dokument duke lëshuar një shtojcë.

14.2 Çdo shtojcë e lëshuar do të jetë pjesë e Dokumenteve për Përzgjedhje dhe do t'i komunikohet me shkrim të gjithë tenderuesve/kandidatëve që kanë marrë Dokumentet për Përzgjedhje.

14.3 Për t'iu dhënë tenderuesve/kandidatëve të mundshëm kohe të mjaftueshme për të marrë parasysh shtesën në përgatitjen e kërkesave për pjesëmarrje/aplikacioneve të tyre, Banka Qendrore do të zgjasë afatin kohor për dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje/aplikacioneve në përputhje me Nenin 22 të Rregullave të Prokurimit.

Përgatitja e KËRKESAVE PËR PJESËMARRJE/ APLIKACIONEVE

15. Gjuha e Kërkesave për Pjesëmarrje/Aplikacioneve

15.1 Kandidatët mund të përgatisin dhe të dorëzojnë **kërkesat për pjesëmarrje/aplikacionet** e tyre dhe dokumentet e lidhura .

16. Dokumentet të cilat përbëjnë Kërkesën për Pjesëmarrje/Aplikacionin

16.1 Kërkesa për Pjesëmarrje/Aplikacionin duhet të përmbajë si në vijim:

- a) Formularin e Dorëzimit të Kërkesës për Pjesëmarrje/Aplikacionin duke përdorur formularin e siguruar në Pjesën III të këtij Dokumenti për Përzgjedhje;
- b) Dokumentet dëshmuese në përputhje me Udhëzimet për Tenderuesit/Kandidatët Neni 5 evidentimi i përshtatshmërisë së Tenderueseve;
- c) Dokumentet dëshmuese në përputhje me Udhëzimet për Tenderuesit/Kandidatët Neni 6, evidentimi i përshtatshmërisë profesionale të tenderueseve;
- d) Dokumentet dëshmuese në përputhje me Udhëzimet për Tenderuesit/Kandidatët Neni 7, evidentimi i gjendjes ekonomike dhe financiare të tenderueseve ;
- e) Dokumentet dëshmuese në përputhje me Udhëzimet për Tenderuesit/Kandidatët Neni 8, evidentimi i mundësisë teknike dhe profesionale të tenderueseve, ;
- f) Dokumentet dëshmuese në përputhje me Udhëzimet për tenderues Neni 10 dhe 11, *nëse kërkohen*; dhe
- g) Ndonjë dokument tjetër që **kërkohet në FDP**.

17. Vulosja dhe shënimi i

17.1 Tenderuesi/kandidati duhet të përgatisë një origjinal të dokumenteve që përbëjnë kërkesën për pjesëmarrje/aplikacionin, siç përshkruhet në Udhëzimet për Tenderuesit/Kandidatët Neni 16 dhe në mënyrë të qartë të shënojë atë "**ORIGJINAL.**" Përveç

Kërkesës për pjesëmarrje

kësaj, Tenderuesi/Kandidati duhet të paraqesë kopje të aplikacionit, në numrin e **shënuar në FDP** dhe në mënyrë të qartë të shënojë ato **"KOPJE"**.

17.2 Tenderuesi/kandidati duhet të vendose kërkesën për pjesëmarrje/aplikacionin origjinal dhe çdo kopje **në zarfa të veçanta** dhe në anën e përparme të secilit zarf do të:

- Shënon qartë **“Origjinal”** ose **“Kopje”**;
- Shënon numrin e Prokurimit siç është e cekur në Dokumentet për Përzgjedhje
- Shënon emrin dhe adresën e Tenderuesit.

17.3 Zarfet pastaj duhet të mbyllen në një zarf të jashtëm që tregon:

- Adresën dhe vendit e dorëzimit të kërkesave për pjesëmarrje/aplikacioneve;
- Numrin e Prokurimit;
- Paralajmërim, se zarfi nuk duhet të hapet para datës dhe kohës së hapjes së kërkesës për pjesëmarrje/aplikacionit;
- Emrin dhe Adresën e Tenderuesit/Kandidatit.

Dorëzimi dhe Hapja e Kërkesave për Pjesëmarrje

18. Afati i fundit për dorëzim të Kërkesave për Pjesëmarrje/Aplikacioneve

18.1 Kërkesat për Pjesëmarrje/Aplikacionet do të pranohen nga Banka Qendrore në adresë dhe jo më vonë se data dhe koha e **shënuar në FDP**.

19. Kërkesat për Pjesëmarrje/Aplikacionet e vonuara

19.1 Banka Qendrore nuk do marrë në konsideratë ndonjë kërkesë për pjesëmarrje/aplikacion që arrin pas afatit të fundit për dorëzimin të kërkesave për pjesëmarrje/aplikacioneve. Cilado kërkesë për pjesëmarrje/aplikacion i pranuar nga Banka Qendrore pas afatit të fundit për dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje/aplikacioneve do të deklarohet i vonshëm dhe do t'i kthehet tenderuesit/kandidatit i pa hapur.

20. Hapja e Kërkesave për Pjesëmarrje/Aplikacioneve

20.1 Banka Qendrore do të bëjë hapjen e kërkesave për pjesëmarrje/aplikacioneve në adresën, datën dhe kohën **e shënuar në FDP**.

20.2 Gjatë Hapjes, Banka Qendrore do të lexon me zë vetëm emrin dhe adresën e tenderuesit/kandidatit. E tërë kjo do të regjistrohet në procesverbalin e takimit të hapjes, e cila do të nënshkruhet nga Zyrtari i Prokurimit dhe nga të gjithë anëtarët e komisionit të hapjes.

Procedurat për Vlerësimin e Kërkesave për Pjesëmarrje/Aplikacioneve

- 21. Konfidencialiteti**
- 21.1 Informatat në lidhje me vlerësimin e Kërkesave për Pjesëmarrje/Aplikacioneve, dhe rekomandimet për përzgjedhje, nuk do të zbulohen tek Tenderuesit/Kandidatët apo tek ndonjë person tjetër i cili nuk ka lidhje me këtë proces deri në njoftimin e Tenderueseve/Kandidatëve për procesin e përzgjedhjes.
- 22. Vlerësimi i Kërkesave për Pjesëmarrje/Aplikacioneve**
- 22.1 **Kërkesat për Pjesëmarrje/Aplikacionet** e pranuar me **Kohë** do të shqyrtohen dhe vlerësohen në përputhje me kërkesat e këtij dokumenti.
- 22.2 Të gjithë tenderuesit/kandidatët që kanë paraqitur dokumentacionin e nevojshëm i cili tregon ose konfirmon se tenderuesit/kandidatët kanë të drejtë dhe plotësojnë kërkesat minimale të përzgjedhjes do të konsiderohen të të përzgjedhur për të marrë një ftesë për tender.
- 23. Sqarimi i Kërkesave për Pjesëmarrje/Aplikacioneve**
- 23.1 Për të lehtësuar vlerësimin e kërkesave për pjesëmarrje/aplikacioneve, Banka Qendrore mund të kërkojë nga secili tenderues/kandidat sqarim mbi kërkesën për pjesëmarrje/aplikacionin e tij/saj, i cili do të dorëzohet brenda një periudhe të arsyeshme kohore. Secila kërkesë për sqarim dhe të gjitha sqarimet do të jenë me shkrim.
- 23.2 Nëse një tenderues/kandidat nuk jep sqarime të informacionit të kërkuar në datën dhe kohën e përcaktuar në kërkesën e BQK-së, kërkesa për pjesëmarrje/aplikacioni i tij do të refuzohet.
- 24. Njoftimi i Përzgjedhjes**
- 24.1 Pasi që Banka Qendrore ka përfunduar vlerësimin e kërkesave për pjesëmarrje/aplikacioneve do të njoftojë të gjithë Tenderuesit/Kandidatët me shkrim për emrat e atyre tenderuesve/kandidatëve të cilët janë përzgjedhur.
- 25. Ftesa për Tenderim**
- 25.1 Menjëherë pas njoftimit të rezultateve të përzgjedhjes, Banka Qendrore do të ftoj ofertat nga të gjithë ata Tenderues/Kandidatë të cilët janë përzgjedhur.
- 25.2 Nga tenderuesit/kandidatët mund të kërkohet që të ofrojnë sigurimin e ofertës si dhe sigurimin mbi ekzekutimin e kontratës në format dhe shumat që do të specifikohen në Dosjen e Tenderit.
- 26. Kriteri i Dhënies**
- 26.1 Kontrata do të shpërblehet sipas kriterëve për dhënien e kontratës siç janë **shënuar në FPD**.
- 27. Ankesat**
- 27.1 Sipas nenit 48 të Rregullës për Prokurimin në BQK, kandidatët/ofertuesit mund të kundërshtojë me shkrim vendimin e Bankës Qendrore për refuzim të kërkesës apo tenderit të tyre brenda 5 ditësh nga marrja e njoftimit.

27.2 Ankesat do te dorëzohen nëpërmjet Njesisë së Prokurimeve, e cila pas trajtimit të ankesës, do ti dorëzojë Komisionit të Ankesave të gjitha shkresat e lëndës duke përfshirë edhe arsyetimin lidhur me bazueshmërinë e ankesës.

PJESA II: FLETA E TË DHËNAVE PËR PËRZGJEDHJE(FDP)

Të dhënat e mëposhtme specifike do të plotësojë, të shtojnë, ose të ndryshojnë dispozitat në Udhëzimet për Tenderuesit/Kandidatët. Kurdo që paraqitet ndonjë mospërputhje, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato në Udhëzimet për Tenderuesit.

Udhëzimet për Tenderuesit/Kandidatët		Përmirësimet/Ndryshimet e Neneve relevante të Udhëzimeve për Tenderuesit/Kandidatët
Përshkrimi i Nenit	Nr. i Nenit	
Fusha e Kërkesës për Pjesëmarrje/Aplikacionit	1.1	Emri: Banka Qendrore e Republikës së Kosovës - BQK, Zyra e Arkivit të BQK-së Adresa: Rr. Luan Haradinaj nr. 2 Qyteti: Prishtinë; Kodi Postar: 10000; Republika e Kosovës Adresa elektronike: www.bqk-kos.org E-mail: prokurimi@bqk-kos.org Telefoni: 038 222 055 lok 224
	1.2	Titulli i kontratës dhe numri i aktivitetit të Prokurimit është: “Furnizim me automjet transportues (furgon) të blinduar” Nr. prok. BQK 26 051 113
	1.3	Procedura konkurruese me negociim
	1.4	Versioni i plotë i njoftimit të kontratës mund të shkarkohet nga faqja elektronike e Bankës qendrore-së: www.bqk-kos.org
	1.5	Kërkesat për Pjesëmarrje/Aplikacionet duhet të dorëzohet në adresën e përmendur në 1.1
Lloji i kontratës	2.1	Kontratë furnizimi Banka Qendrore prokuron vetëm në emër të saj
Qëllimi i Kontratës	3.2	Qëllimi i kontratës është furnizimi me një automjet të ri të blinduar të tipit furgon (VAN), me sistem automatik të transmetimit, motor diesel, kapacitet transporti për ekuipazh dhe ngarkesë, si dhe me sisteme të integruara të sigurisë dhe mbrojtjes. Automjeti do të pajiset me nivel të avancuar të blindimit balistik për kabinën dhe hapësirat e brendshme, xhama balistikë, sisteme elektronike të sigurisë, alarm, interkom, sisteme kontrolli të qasjes, kamera monitorimi, pajisje emergjente dhe elemente të tjera të sigurisë fizike dhe operative.

		<p>Specifikimet teknike të detajuara, kërkesat për certifikim, standardet e blindimit, dokumentacioni teknik dhe kriteret shtesë për mundësitë teknike dhe profesionale do t'u dërgohen kandidatëve që përzgjidhen dhe ftohen të paraqesin tender në fazën e dytë të procedurës.</p>
Kërkesat dhe kushtet e dërgesës	4.1	<p>Vendi i zbatimit të kontratës është: Objekti i Bankës Qendrore të Kosovës, Rr. Luan Haradinaj nr. 2, 10000 Prishtinë</p>
Pranueshmëria e Tenderuesëve	5.4	<p>Në rast të dështimit të dorëzimit të këtyre dokumenteve, tenderuesi në fjalë do të refuzohet.</p> <p>Dokumentet të cilat do të kërkohen si dëshmi për përmbushje të kërkesave të pranueshmërisë janë si vijon:</p> <p><u>Kërkesa 1:</u> Deklarata nën betim se tenderuesi/kandidati përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë. <u>Evidenca 1:</u> Deklaratë nën betim e plotësuar dhe nënshkruar duke përdorur formën në “Aneksin 1” të dokumentit për përzgjedhje.</p> <p><u>Kërkesa 2:</u> Formulari i dorëzimit të kërkesës për pjesëmarrje/aplikacionit në formën standarde siç gjendet në Dokumentin për Përzgjedhje, Pjesa III <u>Evidenca 2:</u> Formulari i dorëzimit të kërkesës për pjesëmarrje/aplikacionit duhet të plotësohet me informatat siç kërkohen në formular dhe duhet të nënshkruhet dhe vuloset.</p>
Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale	6.1	<p><u>Dëshmitë lidhur me kërkesat e përshtatshmërisë profesionale duhet të dorëzohen nga tenderuesit para se Banka Qendrore të merr vendimin final për përzgjedhje.</u></p> <p><u>Kërkesa 3:</u> Dëshmi nga administrata tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se tenderuesi në fjalë nuk është me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para dorëzimit të kërkesës për pjesëmarrje/aplikacionit. . <u>Evidenca 3:</u> Një vërtetim i lëshuar nga Administrata Tatimore e vendit tuaj të themelimit, se ju nuk jeni me vonesë në pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit përpara dorëzimit të kërkesës për pjesëmarrje/aplikacionit.</p> <p><u>Kërkesa 4:</u> Regjistrimi si tenderues në regjistrin profesional, komercial dhe/ose të korporatës në vendin e juaj të themelimit. <u>Evidenca 4:</u> Kopja e certifikatës së regjistrimit me informatat mbi biznesin.</p> <p><u>Kërkesa 5:</u> Dëshmi se kompania nuk është në falimentim ose nën administrim të dhunshëm gjyqësorë të lëshuar nga Gjykata. <u>Evidenca 5:</u> Vërtetim nga Gjykata për Çështje Ekonomike i lëshuar së paku deri në tremujorin e fundit përpara dorëzimit të të kërkesës për</p>

		<i>pjesëmarrje/aplikacionit.</i>
Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare	7.1	Nuk aplikohen
Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	8.1	<p><u>Kërkesa 6:</u> <i>Tenderuesi/kandidati duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses së paku një kontratë të furnizimeve me automjete ose automjeteve të specializuara ose pajisjeve të sigurisë ose zgjidhjeve të ngjashme, gjatë 3 (tri) viteve të fundit (2023, 2024 dhe 2025, përfshirë edhe 2026 deri në shpalljen e këtij njoftimi për kontratë).</i></p> <p><u>Evidenca 6.</u> <i>Tenderuesi duhet ta plotësoj formularin standard për kontratat e ngjashme duke përdorur formën në “Aneksin 4” të dokumentit për përzgjedhje.</i></p> <p>Formulari në “Aneksin 4” i plotësuar dhe nënshkruar/vulosur me furnizimet e ngjashme të realizuara ne tri vitet e fundit duke saktësuar furnizimet e realizuara, shumen e kontratës (nëse është e mundur), datën dhe pranuesin si dëshmi për secilën prej furnizimeve si dhe te dhënat e personit përgjegjës nga autoriteti kontraktues (si nr. i telefonit, email adresa etj)</p>
Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale në Fazën e dytë	8.2	<p><i>Kandidatët njoftohen se, përveç kriterëve të përcaktuara për fazën e parë të procedurës, kandidatëve që përzgjidhen dhe ftohen të paraqesin tender në fazën e dytë mund t'u kërkohet të përmbushin edhe kërkesa shtesë lidhur me mundësitë teknike dhe/ose profesionale. Këto kërkesa dhe dëshmitë përkatëse do të përfshihen në dokumentet e tenderit që do t'u dërgohen kandidatëve të ftuar në fazën e dytë të procedurës dhe përfshijnë, ndër të tjera:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>Katalogun me specifika teknike dhe fletë-datën teknike (Technical Data Sheet) të modelit të ofertuar;</i> • <i>Autorizimi nga prodhuesi, distributori, importuesi i autorizuar, marrëveshje të bashkëpunimit ose dokumentacionit tjetër ekuivalent që dëshmon mundësinë dhe të drejtën e furnizimit të automjetit të ofertuar.</i> • <i>Autorizimin nga kompania blinduese dhe/ose dokumentacion tjetër që dëshmon marrëdhënien zyrtare me kompaninë blinduese;</i> • <i>Deklaratën e konformitetit me standardet përkatëse UNI EN për masat e sigurisë;</i> • <i>Certifikatat balistike të pjesëve të blinduara;</i> • <i>Udhëzuesin e përdorimit të sistemeve të sigurisë dhe planin e trajnimit të personelit;</i> • <i>Deklaratën mbi garancinë minimale;</i>

		<ul style="list-style-type: none"> • <i>Dëshmi dhe dokumente të tjera teknike që do të specifikohen në dokumentet e tenderit.</i>
Krijimi i një grupi të kandidatëve	10.1	<p>e. një deklaratë e qartë ku të gjithë anëtarët e grupit janë bashkërisht dhe individualisht përgjegjës tek Banka Qendrore gjatë procesit të para-kualifikimit dhe, në rast se grupi para-kualifikohet, gjatë procesit të tenderimit, dhe në rast se grupit i epet kontrata, gjatë ekzekutimit të kontratës.</p> <p>f. Një deklaratë të nënshkruar nga secili anëtarë, duke konfirmuar pjesëmarrjen e tyre në grup dhe se ata nuk janë duke marrë pjesë në mënyre individuale dhe/apo në ndonjë grup tjetër që marrin pjesë në procedurën e njëjtën të prokurimit;</p> <p>g. një deklaratë të nënshkruar nga të gjithë anëtarët e grupit të cilët autorizojnë partnerin kryesor për të vepruar në emër të grupit, dhe</p> <p>h. Të gjitha anëtarët e grupit të tillë duhet të jenë të përshtatshëm dhe do të sigurojnë dëshminë mbi përshtatshmërinë e tyre, siç është përmendur në paragrafin 5.4 të kësaj FDP.</p>
Nën-kontraktimet	11.1	N/A
Informata shtesë apo sqaruese	13.1	<i>Cdo kërkesë për sqarime shtesë mund të bëhet deri më datë 19.06.2026 duke bërë kërkesë me shkrim në email adresën: prokurimi@bqk-kos.org</i>
Vulosja dhe Shënimi i Kërkesave për Pjesëmarrje/Aplikacione	17.1	Kërkohet vetëm Kërkesa për Pjesëmarrje/Aplikacioni në origjinal
Afati i fundit dhe vendi i dorëzimit të kërkesave për pjesëmarrje/aplikacione	18.1	Afati i fundit për dorëzim është: 24.06.2026 në ora 14:00 në adresën: BQK, Rr. Luan Haradinaj nr. 2, 10000 Prishtinë. Zyra e Arkivës
Hapja e aplikacioneve	20.1	Hapja e kërkesave për pjesëmarrje/aplikacione do të bëhet me: 24.06.2026 në ora 14:30 në objektin e BQK-se, Rr. Luan Haradinaj nr. 2, 10000 Prishtinë.
Kriteri i dhënies	26	Tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët
Ankesat	27.3	<i>Sipas nenit 48 të Rregullës për Prokurimin në BQK</i>

PJESA III: FORMULARI I DOREZIMIT TË KËRKESËS PËR PJESËMARRJE/APLIKACIONIT

Për : Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Titulli i kontratës:

1. Ne kemi shqyrtuar dhe pranuar përmbajtjen e plotë të Dokumentit të Përzgjedhjes me Nr. prok. BQK 26 051 113. Ne pranojmë dispozitat e saj në tërësi, pa rezervim ose kufizim.
2. Ne konfirmojmë se:
 - a) Ne kemi të drejtë të marrim pjesë në aktivitetin e prokurimit ose për zbatimin e një kontratë
 - b) Ne jemi të regjistruar në regjistrin përkatës profesional dhe / ose ne kemi të drejtë të ushtrimit të veprimtarisë profesionale;
 - c) Ne plotësojmë të gjitha kushtet e paraqitura nga Banka Qendrore, përkritazi me kapacitetet teknike dhe profesionale;

Në mënyrë që të dëshmojmë se ne jemi të kualifikuar, ne prezantojmë këtë listë të dokumenteve të kërkuara *[shëno listën e dokumenteve]*

3. Ne e bëjmë këtë kërkesë për pjesëmarrje/aplikacion në të drejtën tonë të udhëhequr nga vetja. Ne konfirmojmë se ne nuk jemi duke aplikuar për të njëjtën kontratë në ndonjë formë tjetër.

[Në rast të një konsorciumi]

Ne jemi duke e bërë këtë kërkesë për pjesëmarrje/aplikim **si partner në konzorcium** të udhëhequr nga *[shëno emrin e udhëheqësit]*. Ne konfirmojmë se ne nuk jemi duke aplikuar për kontratë të njëjtë në ndonjë formë tjetër. Konfirmojmë, si partner në konsorcium, se të gjithë partnerët, bashkërisht dhe individualisht jemi përgjegjës tek Banka Qendrore gjatë procesit të përzgjedhjes dhe, në rast se grupi përzgjedhet, gjatë procesit të tenderimit, dhe në rast se grupit i epet Kontrata, gjatë ekzekutimit të kontratës, se partneri udhëheqës është i autorizuar të angazhohet, dhe të marr udhëzime për dhe në emër të secilit anëtar, dhe se të gjithë partnerët në ndërmarrjen e përbashkët/konsorcium janë të obliguar të mbeten në ndërmarrjen e përbashkët/konsorcium gjatë gjithë periudhës së realizimit të kontratës.

4. Ne do ta informojmë Bankën Qendrore menjëherë nëse ka ndonjë ndryshim në rrethanat e mësipërme në cilëndo fazë të procesit të prokurimit. Gjithashtu ne e dimë dhe pranojmë që të gjitha informatat e pasakta ose jo të plota të cilat jepen me qëllim në këtë kërkesë për pjesëmarrje/aplikim, mund të kenë si rezultat përjashtimin tonë nga kjo dhe nga kontratat tjera.

5. Thëksojmë që Banka Qendrore nuk është i obliguar të vazhdojë me këtë proces të përzgjedhjes. Ai nuk do të shkaktojë detyrime ndaj nesh nëse e bën këtë.

DORËZUAR NGA

IDENTIFIKIMI I KANDIDATËVE	
EMRI I KOMPANISË	
ADRESA E PLOTË	
PËRFAQËSUAR NGA:	
EMRI	
POZITA	
NËNSHKRIMI	
DATA	
VULA	

[Në rast të grupit të Kandidatëve:]

	Emri(at)	Adresa-Vendqëndrimi
Udhëheqësi 1*		
Etj ... *		

* shtoni / fshini rreshtat plotësues për partnerët sipas nevojës. Vini re se një nënkontraktor nuk konsiderohet të jetë një partner për qëllimet e kësaj procedure të tenderit.

Emri dhe Mbiemri i personit të autorizuar për të nënshkruar kërkesën për pjesëmarrje/aplikacionin në emër të Konzorciumit: **[shëno emrin dhe mbiemrin]**

Nënshkrimi: **[nënshkrimi i personit të autorizuar]**

Vendi dhe data: **[shëno vendin dhe datën]**

Vula e Udhëheqësit: _____

PJESA IV: ANEKSET

Aneks 1

DEKLARATA NËN BETIM

Unë, i poshtë nënshkruari, duke përfaqësuar: [kandidati/tenderuesi që dorëzon kërkesën për pjesëmarrje/aplikacionin] deklaroj nën betim se kandidati/tenderuesi përmbush kërkesat e përshtatshmërisë.

Unë vërtetoj se i kam lexuar kërkesat e përshtatshmërisë në fjalë dhe siguroj se kandidati/tenderuesi në fjalë plotësisht i përmbush këto.

Unë pranoj mundësinë e sanksionimeve penale dhe civile, gjobave dhe dëmeve nëse ofertuesi në fjalë me qëllim apo për shkak të pakujdesisë dorëzon çfarëdo dokumenti ose deklaratë që përmban informata përmbajtësisht të gabueshme ose mashtruese.

IDENTIFIKIMI I KANDIDATIT	
Emri i OE:	
Adresa e plotë:	
Përfaqësuar nga:	
Emri	
Pozita	
Nënshkrimi	
Data	
Vula	

Aneksi 2 KËRKESE PËR SEKRET AFARIST

Për: [emri dhe adresa e autoritetit kontraktues]
(Këtu "")

DUKE PASUR PARASYSH SE [shëno emrin e Kandidatit/Tenderuesit] (më tej "Kandidati/Tenderuesi"), duke përmbushur kërkesat e Dokumentit për Përzgjedhje nën Nr. e Prokurimit të sipër-përmendur, Neni 7 dhe 8 të Udhëzimit për Tenderuesit/Kandidatët, ka dërguar informacionet sekrete afariste, si në vijim:

Identifikimi i informacioneve konfidenciale dhe referimi në pjesët e dokumenteve të dërguara:

DHE DUKE PATUR PARASYSH SE informatat e përmendura janë deklaruar që (i) nuk janë pronë publike, dhe (ii) janë të mbrojtura nga zbulimi i qëllimshëm ose nga pakujdesia nga ana e Kandidatit/Tenderuesit;

DHE DUKE PATUR PARASYSH SE qasja publike në informacionet e përmendura do të rezultonte me dëmtimin material të interesave legjitime komerciale të Kandidatit/Tenderuesit për arsyt vijuese:

Deklaratë mbi natyrën e dëmit të tillë material dhe arsyt pse do të duhej të shfaqet:

PRANDAJ, unë, i poshtë nënshkruari, duke përfaqësuar Kandidatin/Tenderuesin, nëpërmjet kësaj shpreh dëshirën që Banka Qendrore t'i klasifikojë dhe mirëmbajë informacionet e përmendura si informacione sekrete afariste.

IDENTIFIKIMI I KANDIDATIT/TENDERUESIT	
Emri i Kompanisë	
Adresa e plotë:	
Përfaqësuar nga:	
Emri	
Pozita	
Nënshkrimi	
Data	
Vula	

Aneksi 3**KËRKESË PËR INFORMATA SHITESË**

Për: [emri dhe adresa e autoritetit kontraktues]

DUKE MARRË PARASYSH SE [emri i Kandidadtit/Tenderuesit] (më tej “Kandidati/Tenderuesi”), pas pranimit të Dokumentit për Përzgjedhje nën Nr. e Prokurimit të sipër-përmendur, beson se nevojiten informacionet shtesë ose informacionet sqaruese si në vijim:

Identifikimi i informacioneve shtesë ose i informacioneve sqaruese, përfshirë referimet në pjesën apo në pjesët e Kërkesës për Pjesëmarrje/Aplikacionit:

PRANDAJ, unë, i poshtë nënshkruari, duke përfaqësuar Kandidadion/Tenderuesin, nëpërmjet kësaj kërkoj marrjen e informacioneve të identifikuar.

Identifikimi i Kandidatit/Tenderuesit	
Emri i OE:	
Adresa e Plotë:	
Adresa e Plotë:	
Emri:	
Pozita:	
Nënshkrimi:	
Data:	
Vula:	

Aneksi 4	LISTA E FURNIZIMEVE TE NGJASHME TË REALIZUARA NE 3 VITET E FUNDIT (DUKE FILLUAR NGA DATA E PUBLIKIMIT TE KËTIJ NJOFTIMI PËR KONTRATE)
-----------------	--

Ky Aneks është obligativ qe te plotësohet dhe ti bashkëngjiten certifikatat përkatëse ose referencat apo ndonjë dokument tjetër qe evidenton liferimin e tillë.

Nr.	Titulli i kontratës	Data e nënshkrimit te kontratës	Vlera e ekzekutuar e kontratës (nëse është e mundur)	Emri I Blerësit	E-maili i Blerësit	Numri i telefonit te Blerësit
1						
2						
3						
4						
5						
6						
7						

(Shto/fshij sipas nevojës)

Banka Qendrore ka të drejtë të verifikojë të dhënat e paraqitura në këtë Aneks dhe nëse vërtetohet ndonjë dëshmi e rreme, oferta e tillë do të konsiderohet si një oferte e pa përgjegjshme dhe për shkak të paraqitjes së të dhënave të rreme, dhe do të listojmë në listën e zezë te Operatoreve Ekonomik.

VINI RE: Dëshmitë përkatëse për furnizimet e listuara në këtë Aneks (shih dokumentet e kërkuara nën a) dhe b) më poshtë) mund të kërkohen nga tenderuesit/kandidatët në fazën e dytë (tenderuese) të procedurës:

- a) certifikatat përkatëse ose referencat qe evidentojnë realizimin e furnizimeve dhe/ose
- b) kopjet e kontratave përkatëse.